



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë nr. Ref: 69/20

Data: 05.11.2020

Duke u bazuar në nenin 28, 29 dhe çështjet procedurale sipas nenit 34, 35, 50, 54, dhe sipas nenit 13, 15, 17, 19, 20, paragrafi 1.3 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 8 i plotësim ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e datës **05.11.2020**, mori këtë:

V E N D I M

- I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve nga/dhe ndërmjet Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o.(blerësi) dhe “Ampelus Holding Limited (shitësi), për blerjen e 100% të aksioneve. Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Bled dhe adresë biznesi në Pod Skalo 4, 4260, Bled, e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5690366000. Vila Bogatin ka pronar ZTSR Dejavnost Holdingov d.o.o. me 100% të aksioneve, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me 50% të aksioneve të së cilës është pronar Pozavarovalnica Sava , d.d (Sava e Re) , ndërsa 50% të tjera i takojnë Zavarovalnica Triglav, d.d.(Triglav). Kirurski Santorij Rozna Dolina d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë bizensit në Rozna Dolica , cesta IV 45,1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5966809000 (“ Kirurski sanatorij “ ose Shoqëria”) ka pronar Ampelus Holding Limited me 100% të aksioneve.
- II.** Ampelus Holding, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas ligjeve të Qipros, me seli në Limasol dhe adresë biznesi në Arch. Makarios III ,5, 4000, Limasol Qipro, e regjistruar në regjistrin tregtar të Qipros me Nr. HE 156211. Ampelus Holding është pronare e 100% të aksioneve të Shoqërisë.
- III.** SavaRe, në tregjet e jashtme, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës, ka në pronësi; 1. Kompanin e sigurimeve, Illyria Sh.A., e cila është shoqëri aksionare me Nr. unik identifikues 810483769 dhe Nr. të regjistrimit të biznesit 70152892, me adresë të regjistruar në Sheshin Nëna Terezë Nr.33,10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jo-jetë; dhe 2. Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria – Life Sh.A., shoqëri aksionare me Nr. unik të identifikues 810733837 dhe Nr. të regjistrimit të biznesit 70520893 dhe me adresë të

regjistruar në Sheshi Nëna Terezë Nr. 33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jetësor, 3. Illyria Hospital Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me Nr. të regjistrimit të biznesit 70587513, me adresë të regjistruar në Sheshi Nëna Terezë, Nr.33,10000, Prishtinë, me aktivitete të biznesit: aktivitetet e mjekësisë së përgjithshme, tregtia me shumicë jo e specializuar, tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksore, në dyqane të specializuara, aktivitetet e dentistëve, tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik. Ndonëse, aktivitetet e lartpërmendura janë regjistruar si aktivitete të biznesit të Illyria Hospital Sh.P.K., e njëjta nuk kryen asnjë nga këto aktivitete në Kosovë.

- IV.** Kirurski Santorij Rozna Dolina d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë bizensi në Rozna Dolica , cesta IV 45,1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5966809000 (“ Kirurski sanatorij “ ose Shoqëria”) ka pronar Ampelus Holding Limited me 100% të akisoneve, e cila ofron shërbime të veprimtarisë ambulatore dhe spitalore të specializuara me shërbime të diagnostifikimit, trajtimit, infermierisë dhe të ngjashme. Kirurski Santorij ka një filial me seli në Republikën e Sllovenisë.
- V.** Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë euro).

A R S Y E T I M

NJOFTIMI PËR PËRQENDRIM

1. Më datë, 28.09.2020 Autoriteti Kosvar i Konkurrencës, ka pranuar kërkesën e Njoftimit për Përqendrim nga Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o. dhe “Ampelus Holding Limited, përmes fitimit të kontrollit apo blerjes së 100% të aksioneve.
2. Kërkesa është paraqitur në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji Nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve.

PROCEDURAT E NDJEKURA NGA AUTORITETI:

1. Vërtetimi, me të cilin Autoriteti ka konsideruar lëndën të plotësuar me datën 06.10.2020.
2. Njoftimi i përqendrimit në Web Faqen e Autoritetit me datën 08.10.2020,
3. Autoriteti ka bërë vlerësimin e qëllimit të realizimit të Përqendrimit sipas procedurës së shkurtër.

NJOFTIMI PËR PËRQENDRIM KA TË BËJË ME:

1. Përqendrimi, do të realizohet nga ndërmarrjet, Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o dhe Ampelus Holding Limited e cila është pronare e 100% e të gjitha aksioneve të Kirurski Santorij Rozna Dolina d,o.o.,.
2. Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven , me seli në Bled dhe adresë biznesi në Pod Skalo 4, 4260, Bled , e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5690366000.
3. Ampelus Holding është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas ligjeve të Qipros , me seli në Limasol dhe adresë biznesi në Arch. Makarios III ,5,4000, Limasol Qipro , e regjistruar në regjistrin tregtar të Qipros me Nr. HE 156211.
4. Kirurski Santorij Rozna Dolina d,o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë bizensi në Rozna Dolica, cesta IV 45,1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5966809000.
5. *Të hyrat totale tek Kompania e sigurimeve, Illyria Sh.A. janë:*
 1. Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria-Life,Sh.A.
 2. Illyria Hospital Sh.P.K, janë; Euro XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

BAZA LIGJORE DHE AKTI I PËRQENDRIMIT

1. Bazuar në nenin 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, palët kanë përmbushur detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:
 - a) Qarkullimi i kombinuar i palëve është sipas dispozitës përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji Nr. 04/L-226.
 - b) Blerësi është i regjistruar në Republikën e Kosovës.
 - c) Kontrata e Shitblerjes, datë 31.08.2020.

ANALIZA E TREGUT

Tregu Relevant:

- a. Tregu gjeografik - në transaksionin e propozuar do të jetë territori i Republikës së Sllovenisë.
- b. Tregu i produktit - përfshin, shërbime spitalore, siq janë; shërbime të pacienëve të shtrirë, shërbime të tregut dhe shërbime të pacienëve jo të shtrirë..

EFEKTET E KONKURENCËS NË TREGUN PËRKATËS NGA TRANSAKSIONI I REALIZUAR

1. Përqendrimi, është propozuar në Slloveni, por kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se blerësi ka degën e saj të regjistruar në Republikën e Kosovës, mirëpo si e tillë, nuk ka mundësi të bëjë ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut në Republikën Kosovës.
2. Gjithashtu vlerësojmë që, tregu përkatës mund të mbetet i hapur, që nënkupton i pa përcaktuar përfundimisht.
3. Autoriteti shqyrtoi dhe arriti në përfundimin se, nuk ka efekte negative nga realizimi i këtij përqendrimi, sepse pjesëmarrësit në përqendrim nuk kryejnë aktivitetin e tyre në tregun e Republikës së Kosovës.

Vëmendje:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga Komisioni i AKK-së.

KOMISIONI AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS

(_____)
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anëtare

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. *Palët*
2. *Arkiva*